



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.Dh.Shk.II.nr.436/24

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Eurogoma Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Halit Shaljani, avokat nga Prishtina, kundër debitorit Forca e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit sipas dokumentit të besueshëm - faturave, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës , Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2231/22, të datën 20.12.2023, me datën 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Eurogoma Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2231/22, të datën 20.12.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2231/22, të datën 20.12.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Forca e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.498/22 të datës 16.08.2022 të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj.

Kundër aktvendimit të lartcekur, brenda afatit ligjor, ankesë ka parashtruar përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit në tersi si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktvendimi KPPP.nr.2231/22, të datën 20.12.2023 të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të lihet në fuqi urdhri i përmbartuesit privat P.nr.498/22 të datës 16.08.2022 apo të prishet aktvendimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rivendosje në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale - Dhomat e shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të

Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.498/22 të datës 16.08.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturën nr. 21-SHV01-SHK-28923 e datës 20.12.2021, fature nr. 21-SHV01-SHK-28922 e datës 20.12.2021, fature nr. 21-SHV01-SHK-28990 e datës 21.12.2021, fature nr. 20-SHV01-SHK-3385 e datës 20.12.2021, fature nr. 20-SHV01-SHK-25590 e datës 21.12.2020, fature nr. 20-SHV01-SHK-25595 e datës 21.12.2020, fature nr. 20-SHV01-SHK-25581 e datës 21.12.2020, fature nr. 20-SHV01-SHK-25588 e datës 21.12.2020 dhe fature nr. 20-SHV01-SHK-25591 e datës 21.12.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që kreditorit t'ia paguajë shumën prej 1,722.68€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së Urdhrit për përmbartim deri në datën e pagesave definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit për përmbartim, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri tek përmbushja e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e këtyre sendeve.

Debitori përmes të autorizuarit të tij, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk është i përshtatshëm për përmbartim pasi që pas verifikimit nga ana e Departamenti të Financave të debitorit pasi që ndalesat ka të bëjë me pjesët e papaguara me ndalesat e bëra në përputhje me kontratën e datës 01.11.2019, të lidhur mes kreditorit dhe debitorit, për shkakë të vonesave të liferimit e mallit. Me kërkesë që të aprovohet Prapësimi dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.498/22 të datës 16.08.2022 të shfuqizohet.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit nisur nga fakti se përmbushja e kontratës nuk është shqyrtim në procedurën përmbartimore, pasi që ekzekutohet kërkesat e konstatuara në këto dokumente përmbartimore. Me kërkesë që Prapësimi i debitorit të refuzohet dhe Urdhri Përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.2231/22, të datën 20.12.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Forca e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.498/22 të datës 16.08.2022 të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, duke vendosur me devedivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parapara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, e të

cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve për zbatimin e gabuar të dispozitave të procedurës përbarimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.498/22 të datës 16.08.2022. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se dokumenti i besueshëm-faturat , në bazë të cilit organi përbarues ka caktuar përbarimin, nuk i plotëson tiparet e përbarueshmërisë.

Me Nenin 29 par.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP) është paraparë se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Andaj, në këtë rast nga shkresat e lëndës rezulton se Faturën nr. 21-SHV01-SHK-28923 e datës 20.12.2021, fature nr. 21-SHV01-SHK-28922 e datës 20.12.2021, fature nr. 21-SHV01-SHK-28990 e datës 21.12.2021, fature nr. 20-SHV01-SHK-3385 e datës 20.12.2021, fature nr. 20-SHV01-SHK-25590 e datës 21.12.2020, fature nr. 20-SHV01-SHK-25595 e datës 21.12.2020, fature nr. 20-SHV01-SHK-25581 e datës 21.12.2020, fature nr. 20-SHV01-SHK-25588 e datës 21.12.2020 dhe fature nr. 20-SHV01-SHK-25591 e datës 21.12.2020, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për arsye se përkundër faktit që të njëjtat janë nënshkruar nga ana e debitorit, rrjedhimisht ka prova se të njëjtat janë pranuar nga ana e debitorit , mirëpo lartësia e borxhit apo shumës në fatura nuk është në rregull meqenëse kundërshtimin kundër shumës është bërë në afatin partitiv të përcaktuar në secilën faturë, prandaj rezultojnë që janë të pa përshtatshme për përbarim, prandaj faturat e lartcekura nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk kanë tipare të përbarueshmërisë.

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka pranuar prapësimin me arsyet se urdhri për përbarim është lejuar mbi bazën e faturave të cilat nuk mund të shërbejnë si titull përbarimor, pasi që fatura nuk përmban as elementet për t’u cilësuar si faturë e rregullt apo dokument i besueshëm ngase janë kundërshtuar këto fatura brenda afatit partitiv nga debitori.

Së këndejmi, Gjykata gjen se urdhri për përbarim i caktuar nga përbaruesi privat është lëshuar në bazë të një propozimi për përbarim i cili nuk i ka plotësuar kushtet që kërkohen me Nenin 29 të LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të

kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala debitorë ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështrohet sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka ndaluar urdhrin për caktimin e përbarimit të Përbaruesit Privat, P.nr.498/22 të datës 16.08.2022.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.436/24, me datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi